



### Durrës & Kavajë

**QSHNJP Durrës & Kavajë** zhvilluan në datën 05.08.2024 dhe 09.08.2024 një aktivitet në bashkëpunim me AKPA Durrës, me fokus bashkëpunimin midis dy institucioneve për referimin e rasteve dhe mundësinë për të ndihmuar qytetarët për t'u pajisur me dokumentin provues, vërtetim si punëkerkues i papunë.

**QSHNJP Kavajë** në datën 09.08.2024 dha intervistë informuese rreth ligjit nr.111/2017 dhe shërbimet e Qendrës, për televizionin "Drita TV", Kavajë.

Link: <https://youtu.be/MRLWc8uHztk?si=nRk9x43X3Rghm5->



### Korçë

**QSHNJP Korçë** zhvilloi në datën 22.08.2024, në kuadër të ditës ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Akteve të Dhunës bazuar në fe ose Besim, një aktivitet "street law", për të njohur rëndësinë e ndihmës ndaj viktimave të persekutimit fetar si dhe duke i njohur qytetarët me shërbimet që ofrojnë si qëndër për kategoritë e veçanta të cdo lloji dhune.

### Tiranë

**QSHNJP Tiranë** zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Punësimit dhe AKPA, me fokus bashkëpunimin ndërinstitucional dhe informimit, referimin e rasteve dhe mundësinë për të ndihmuar qytetarët.

**QSHNJP Tiranë** zhvilloi një aktivitet "Street Law", pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Tiranë.



### Pukë

**QSHNJP Pukë** zhvilloi në datën 22.08.2024 një takim me qytetarë të Bashkisë Pukë në ditën ndërkombëtare të përkujtimit të viktimave me bazë besim dhe fe.

**QSHNJP Pukë** zhvilloi në datën 29.08.2024 një takim me përfaqësues të Bashkisë Pukë, si dhe përfaqësues të zyrës së ndihmës ekonomike dhe të pronave dhe qytetarë të kategorive të veçanta.



### Vlorë

**QSHNJP Vlorë** zhvilloi në datën 22.08.2024 një takim me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë, me fokus bashkëpunimin ndërinstitucional për zgjidhjen e problematikave të rasteve të qytetarëve që i drejtohen ndihmës juridike parësore.



**QSHNJP Vlorë** zhvilloi në datën 28.08.2024, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë një trajnim me anëtarë të Komunitetit Rom dhe Egjiptian të qytetit të Vlorës dhe Novoselës, në zbatim me projektin "Për më shumë mundësi arsimimi dhe punësimi për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Vlorë".

### Përmet


**QSHNJP Përmet** zhvilloi në datën 14.08.2024 një aktivitet informues, në kuadër të bashkëpunimit me Postën Shqiptare dhe orjentimin e qytetarëve drejt zyrës me qëllim përfitimin e shërbimit ligjor falas.

**QSHNJP Përmet** zhvilloi në datën 29.08.2024 një aktivitet informues, me qytetarë të komunitetit Egjiptian në lagjen Mejden, ku fokusi i këtij takimi ishin kategoritë e veçanta, persona që përfitojnë nga PAK.



## Pogradec

**QSHNJP Pogradec** organizoi në datën 23.08.2024 një sesion informimi "Street Law" në fshatin Turistik të Tushemisht, Pogradec. Për qytetarët u shpërndan fletpalosje dhe informacione mbi shërbimet që ofran Zyra e Ndhmës Ligjore Falas, shërbimet konkrete që mund të marrin pranë kësaj zyre vendodhjen e saj, etj.



## Gjirokastrë

**QSHNJP Gjirokastrë** organizoi në datën 02.08.2024, një aktivitet pranë Bashkisë Libohovë, në bashkëpunim me organizatën Centre for legal Empowerment (CLE), në kuadër të projektit "LegalTech Access Initiative", me pjesëmarrjen e punonjësve social, punonjës administrativë, si dhe qytetarë.



**QSHNJP Gjirokastrë** në datën 09.08.2024, dha intervistë për median lokale RTGJ, rastet e trajtuara përgjatë periudhës Korrik- Gusht 2024.

Link: [https://youtu.be/SIBwvEawpCk?si=4Rx4k\\_leFUrBAG-8](https://youtu.be/SIBwvEawpCk?si=4Rx4k_leFUrBAG-8)

**QSHNJP Gjirokastrë** në datën 16.08.2024 dha intervistë për median kombëtare RTSH. Link: <https://we.tl/t-9fN7RB8Aj8>

**QSHNJP Gjirokastrë** në datën 21.08.2024, dha intervistë për median kombëtare Euronews Albania. Link: <https://youtu.be/GGmsBH0d0oY?si=DI0jVc9FtHccMgNN>

**QSHNJP Gjirokastrë** në datën 23.08.2024, zhvilloi një takim në bashkëpunim me organizatën Centre for Legal Empowerment (CLE), në kuadër të projektit "LegalTech Access Initiative".

## Tropojë

**QSHNJP Tropojë** zhvilloi në datën 01.08.2024 një takim me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, Zyra Rajonale Kukës Z. Besmir Billa.

**QSHNJP Tropojë** zhvilloi në datën 15.08.2024, në bulevardin "Binak Alia", në qytetin e Bajram Currit një aktivitet "street law" me qytetarë të qytetit.

**QSHNJP Tropojë** mori pjesë në datën 29.08.2024 në takimin e GTN-së me përfaqësues nga Shërbimi Social, NJMF, QSHNJP Tropojë, Komisariati i Policisë, ZA, etj.



## Berat

**QSHNJP Berat** zhvilloi në datën 29.08.2024 në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, një aktivitet "Street Law", në zonën ku banon komuniteti rom.

## Shkodër

**QSHNJP Shkodër** zhvilloi në datën 29.07.2024 në kuadër të planifikimeve mujore, një takim pranë Njesise Administrative Kastrat, Bashkia Malësia e Madhe. Fokusi i takimit ishte ligji nr.111/2017, si dhe ligji nr.20/2020 "Për Procedurat Përfundimtare të kalimit të Pronësisë".

